Misioni

” Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) ka për mision zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve për fushën e zhvillimit rajonal, si dhe stimulimin e aktiviteteve të zhvillimit rajonal në Kosovë, në funksion të rritjes ekonomike, dhe të bashkëpunimit ndër-institucional dhe rajonal për të reduktuar pabarazitë rajonale, duke mbështetur (punësimin dhe gjenerimin e pasurisë/mirëqenies) aktivitete ekonomike në rajone”.

Ministria e Zhvillimit Rajonal
Adresa Rr. Perandori Justinian Nr. 116 Prishtinë, Republika e Kosovës; tel: +383(0)200 64522
E-mail: shkrimorja.MZHR@rks-gov.net

Buletini Vjetor 2018

Ministria e Zhvillimit Rajonal – MZHR
Janar – Dhjetor 2018

Departamentet e MZHR-së

1. **Departamenti për Zhvillim Rajonal;**
2. **Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale;**
3. **Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave;**
4. **Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme;**
5. **Divizioni i Prokurimit;**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2018, Ministria e Zhvillimit Rajonal, ka përmbushur një pjesë të rëndësishme të obligimeve për zbatimin e aktiviteteve nga Plani i Punës për vitin 2018.

Ministria e Zhvillimit Rajonal është organizuar dhe funksionon konform përgjegjësive dhe kompetencave të përcaktuara me Rregulloren e Qeverisë së Kosovës, Nr. 16/2017 (e Ndryshuar dhe e Plotësuar me Rregulloren Nr. 02/2011) për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave.

Hartues i Buletinit Vjetor të MZHR-së

Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave

Buletini vjetor i MZHR-së, pasqyron veprimet dhe rezultatet e arritura sipas objektivave të Planit të Punës 2018:

- **Hartimi dhe koordinimi i politikave për zhvillim socio-ekonomik rajonal;**
- **Zhvillimi i profileve dhe indikatorëve për zhvillim rajonal;**
- **Zhvillimi dhe implementimi i programeve për zhvillim rajonal.**

.

Buletini bazohet në raportin e të dhënave periodike të departamenteve të MZHR-së, përkatësisht në:

1. Departamentit për Zhvillim Rajonal;
2. Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale;
3. Departamentit për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave;
4. Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
5. Divizioni i Prokurimit

1. ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2018, MZHR ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së Qeverisë për vitin 2018, të cilat kanë për qëllim arritjen e prioriteteve strategjik

Në kuadër të zhvillimit dhe koordinimit të politikave për zhvillimin rajonal, aktivitetet e zbatuara janë shtrirë përmes:

- Hartimit të politikave për zhvillim rajonal;
- Implementimi i Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, përmes lansimit dhe financimit të Skemës së Grantëve për biznese;
- Implementimi i Programit për Zhvillim Rajonal për financimin e projekteve kapitale në të gjitha komunat e Kosovës;
- Lansimi i dy thirrjeve për mbështetje financiare të Organizatave të Shoqërisë Civile.

***Foto 1**: Punëtoria e përbashkët dy ditore 17-18.05.2018 me delegacionin nga Shqipëria "Bashkëpunimi në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal.*

Në vitin 2018 është hartuar Dokumenti "Profilet Rajonale" Ministria e Zhvillimit Rajonal bazuar në mandatin e saj ligjor ka miratuar Dokumentin e Profileve Rajonale duke u bazuar në rregulloren 4/2018 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Në kuadër të këtij dokumenti të Profileve Rajonale synojmë që të pasqyrojmë elementet ekonomike të çdo rajoni të Republikës së Kosovës. Fokusi ynë kryesor në kuadër të këtij dokumenti është vënia në pah e resurseve ekonomike, natyrore dhe atyre humane në pesë rajonet ekonomike: Lindje, Jug, Qendër, Perëndim dhe Veri.

***Foto 2**: Ministri z. Rasim Demiri, Zëvendësministrja znj. Magbule Shkodra dhe Sekretari e Përgjithshëm z. Fatos Qerimi, gjatë një vizite zyrtare në Shkup. Ku u takuan me Ministrin e Ekonomisë të Republikës së Maqedonisë z. Kreshnik Bekteshi.*

2. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT ZHVILLIMI RAJONAL I BALANCUAR PËRMES SKEMES SË GRANTEVE PËR BIZNESE

Projektet nga skema e granteve nga Ministria e Zhvillimit Rajonal janë shpërndarë si më vijim:

- ***LOT-1- Përfshinë gjitha projektet –bizneset Start-UP në vlerë deri 5000€***
- ***LOT-2- Përfshinë gjitha projektet- bizneset të cilat kanë përvojë biznesore deri dy (2)vite në vlerë deri 10.000€***
- ***LOT-3- Përfshinë gjitha projektet bizneset e konsoliduara të cilat kanë përvojë më shume se dy (2) vite në vlerë deri 20.000€***

MZHR

145

Grante, në vlerën prej 1,346,806.00 euro.

561 **të punësuar, në**

5 rajone ekonomike në Republikën e Kosovës.

MZHR i ka ndarë grantet sipas rajoneve si në vijim:

- *(30) tridhjetë projekte në rajonin socio-ekonomik Qendër;*
- *(29) njëzetë e nëntë projekte në rajonin socio-ekonomik Lindje;*
- *(31) tridhjetë e një projekte në rajonin socio-ekonomik Perëndim;*
- *(24) njëzet e katër projekte në rajonin socio ekonomik Veri;*
- *(31) tridhjetë e një projekte në rajonin socio-ekonomik Jug.*

***Foto 3**: -Sesioni informues në rajonin Perëndim lidhur me lansimin e Skemës së Granteve për biznese 2018.*

3. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT PËR ZHVILLIM RAJONAL, FINANCIMI I PROJEKTEVE KAPITALE NË KOMUNAT E KOSOVËS;

"Programin për zhvillim rajonal" i cili ka përfshirë financimin e projekteve kapitale në të gjitha Komunat e Kosovës**;** Programi për Zhvillimi Rajonal kishte për qëllim të kontribuojë në krijimin e kushteve për zhvillimin e ekonomik rajonal të qëndrueshëm në të gjitha rajonet ekonomike të Kosovës dhe për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik, mjedisor dhe kulturor të balancuar.

***Foto 4**: Inspektimi i punimeve " Ndërtimi i rrugës në lagjen Fejza te fshatit Begrac komuna e Kaçanikut.*

MZHR në vitin 2018 gjithsej ka bashkëfinancur

20 projekte

kapitale në komuna, në vlerë prej

1,535.954, 36 Euro.

- ***Në rajonin Qendër –(Drenas, Lipjan, Obiliq dhe Shtime) Total : 330,000.00 €***
- ***Në rajonin Lindje (Hani i Elezit Kaçanik dhe Kamenicë) Total:221,672.84€***
- ***Në rajonin Perëndim (Deçan, Pejë, Junik dhe Klinë) Total:322,080.00€***
- ***Në rajonin Veri (Mitrovicë Jugore dhe Skenderaj) Total:40,438.50 €***
- ***Në rajonin Jug (Prizren, Dragash, Mamushë Suharekë dhe Rahovec) Total: 621,763.02 €***

5. LANSIMI I DY THIRRJEVE PËR MBESHTETJE FINANCIARE TË OJQ-ve

MZHR ka implementuar projektin për mbështetje financiare e thirrjes së parë me 50,000 euro. Shuma minimale dhe maksimale e përkrahjes së shoqërisë civile, nga thirrja për mbështetje të OJQ-ve, e cila ndihmon promovimin e zhvillimit ekonomik rajonal të balancuar, është si në vijim:

- Promovimi i Zhvillimit Socio – Ekonomik Rajonal të Balancuar:€ 1000- €3000;
- Nxitja e rrjetëzimeve me qellim të zhvillimit socio – ekonomik rajonal:€1000- €5000;
- Nxitja dhe vetëdijesimi i të rinjve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik:€1000-€8000.

Thirrja e dytë është me 60,000 euro. Shuma minimale dhe maksimale e përkrahjes financiare, është si në vijim:

- Promovimi i Zhvillimit Socio – Ekonomik Rajonal të Balancuar: €3000-€10,000;
- Nxitja e rrjetëzimeve me qellim të zhvillimit socio – ekonomik rajonal: €1000 - €5000;
- Nxitja dhe vetëdijesimi i të rinjve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik: €1000 -€3000.

23 projekte

Nga thirrja e parë janë financuar

12 organizata me vlerë 45,350 €

dhe nga thirrja e dytë 11

organizata me vlerë 64.680 €

Vlera dhe titujt e projekteve-

1. 4,180.00 € " KËSHILLA PËR BLETARËT E RINJË DHE PËR PUNUESIT E MJALTËS NË RAJONIN E ANAMORAVËS;
2. 2,800.00 € "Zhvillimi i shkathtësive për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve tek të rinjtë dhe gratë e Shtimes dhe Lipjanit";
3. 3,200.00 € " Ora për programin hap i zhvillimit ekonomik";
4. 3,000.00 € Avancimi Socio – Ekonomik përmes Platformave Përkrahëse Inovative Socio – Ekonomike nga Rinia dhe Gratë;
5. 6,900.00 € "Veprimtaria prodhuese në rajonet ekonomike të Kosovë;
6. 2,900.00 € "Razvoj omladinskog i zenskog preduzetnsva";
7. 2,800.00 € "Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të nxënësve dhe mësimdhënësve në arsimin para universitar në shkruar-jen dhe menaxhimin e projekteve inovative" ;
8. 2,500.00 € "Nxitja dhe vetëdijesimi i të rinjve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik" ;
9. 2,500.00 € "Promocija socio-ekonosmog razvoja regiona JUG (Opstine Prizren I Dragas);
10. 2,500.00 € ''Përgatitja e projekteve cilësore për Zhvillim ekonomik dhe social'';
11. 5,500.00 € 'Mbështetja e bizneseve për zhvillim socio-ekonomik'';
12. 3,400.00 € ''Të rinjtë ndërmarrës'';
13. 9.000.00 € "Promovimi i Zhvillimit të Balancuar Socio-Ekonomik në rajonin Perëndimor të Kosovës";
14. 8.200.00 €"Promovimi dhe ngritja e kapaciteteve lokale në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar në rajonin Jug";
15. 9.100.00 € "Rritja e kohezionit zhvillimor në rajonin ekonomik Qendër";
16. 3.000.00 € "Parlamenti rural- mundësi për bashkëpunim e rrjetëzim për zhvillim ekonomik-social";
17. 8.300.00 € "Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar socio-ekonomik në rajonin Veri";
18. 3.500.00 € "Saradnja za bolji socio-ekonomski razvoj";
19. 3.000.00 € "Nxitja dhe vetëdijesimi i të rinjve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik";
20. 3.000.00 € "Fuqizimi dhe avancimi i të rinjve dhe grave për hartimin e projekteve për grante";
21. 8.500.00 € "Promovimi i Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar në rajonin Lindje";
22. 6,100.00 € 'Zhvillimi i kapaciteteve lokale për krijimin e ambientit më të favorshëm për biznes në fushën prodhuese dhe zëvendësimin e importit'';
23. 2,890.00 € 'Promovimi në fushën e zhvillimit socio-ekonomik për rininë dhe gratë përmes ngritjes së kapaciteteve''.

***Foto 5**: Takimi me përfaqësuesit e bizneseve, AZHR PERËNDIM duke implementuar projektin: "Promovimi i Zhvillimit të Balancuar Socio-Ekonomik në rajonin Perëndimor të Kosovës, financuar nga MZHR.*

6. Administrata dhe financat

MZHR ka bërë dorëzimin e Kesh-Planit në Ministrinë e Financave. Gjithashtu është hapur petty cash-i, janë mbledhur të dhënat lidhur me pasqyrat financiare. Në Ministrinë e Financave është dorëzuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për periudhën 2019-2021, e cila është aprovuar në Qeveri.

Ka vazhduar procesi i analizimit të ecurisë së shpenzimeve në periudhën e dytë të vitit 2018, i cili është bërë në baza mujore dhe sipas nevojave.

Lidhur me aspektet e menaxhimit financiar dhe kontrollit siç janë: delegimi i autorizimeve për shpenzime, lista e rreziqeve etj, është dorëzuar pyetësori vetë vlerësuese në MF. Në vazhdimësi është bërë pranimi i kërkesave iniciuese për zotimin e mjeteve në SIMFK, regjistrimi i zotimeve dhe i shpenzimeve në SIMFK. Është analizuar dhe harmonizuar me raportet e brendshme barazimi i regjistrimit të shpenzimeve me Departamentin e Thesarit në MF që përfshinë kontrollimin e raportit të SIMFK për periudhën janar–dhjetor 2018. Në vazhdimësi është bërë hapja dhe mbyllja e Avanseve për udhëtime zyrtare, si dhe hapja, rimbushja që përfshinë tërheqjen e parave të gatshme nga banka komerciale dhe kthimi i mjeteve. Në baza mujore është bërë regjistrimi i transaksioneve për të gjitha kategoritë ekonomike dhe krahasimi i tyre me raportet e Freebalance. Sa i përket menaxhimit të pasurisë së MZHR-së ka filluar regjistrimin e pasurisë mbi 1,000.00 € në SIMFK, si dhe regjistrimin e pasurisë në sistemin e-pasuria nën 1,000.00 €.

Buxheti total i planifikuar për MZHR ka qenë 4,154,338.83 Euro, Mallra dhe Shërbime 340,000.00 Euro, Shpenzime Komunale 10,000.00 euro, Paga dhe Mëditje 304,338.83 euro, Subvencione dhe Transfere 1,500,000.00 euro dhe Investimet Kapitale 2,000,000.00.

Gjatë këtij viti është ofruar ndihmë në përkthim të materialeve, dokumenteve të ndryshme në gjuhën serbe dhe angleze, ka pasur në vazhdimësi lektorime të dokumenteve në gjuhë zyrtare, janë ofruar përkthim simulant në takime të ndryshme të cilat kanë i kanë zhvilluar njësitë e MZHR-së.

MZHR, ka filluar zbatimin e planit të personelit për vitin 2018, janë iniciuar në vazhdimësi kërkesat për rekrutimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozita të lira, janë kompletuar dosjet lidhur me kërkesat inicuese për procedurat e rekrutimit për pozitat e lira në MZHR, si dhe është bërë njoftimi në faqen zyrtare të MZHR-së për përzgjedhjen e kandidatëve të suksesshëm. Në vazhdimësi përditësohet baza elektronike me të dhëna për stafin e MZHR-së, po ashtu bëhet menaxhimi i udhëtimeve zyrtare, si dhe inventarizimi i dosjeve personale. MZHR koordinon aktivitet me IKAP-in sa i përket fushës së trajnime, si ka koordinim edhe me Agjensionin Anti Korrupsion për sa i përket deklarimit të pasurisë. Është themeluar komisioni për Inventarizimin e dosjeve personale të stafit.

7. PUNËTORIA DHE KONFERENCA VJETORE

Punëtoria e MZHR-së

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2018 MZHR ka mbajtur Punëtorinë "Zhvillimi strategjik dhe vjetor 2019 në fushën e zhvillimit rajonal" Punëtoria treditore e realiyuar nga datat 22 deri me 24 Nëntor 2018 kishte për qëllim prezantimin e të arriturave në vitin 2018, përcaktimin e orientimeve strategjike afatgjate në fushën e zhvillimit rajonal, si dhe hartimin e Planit të Punës për vitin 2019.

Foto 7: Pamje nga dita e parë e Punëtorisë"Zhvillimi strategjik dhe vjetor 2019 në fushën e zhvillimit rajonal" nga stafi i MZHR-së

- ## Konferenca vjetore

Ministria e Zhvillimit Rajonal, gjatë vitit 2018 ka mbajtur konferencën e fund vitit, së bashku më kryetarët e komunave, përfaqësuesit e bizneseve, donatorët dhe të gjitha institucionet që kanë bashkëpunuar me MZHR-në.

Ministri i Zhvillimit Rajonal z. Rasim Demiri tha se "Kjo ministri është shembull për të gjitha ministritë, për të gjitha komunitete pakicë, kemi lejuar të përfshihen komunitet pakicë , pakicat asnjëherë s'kanë qenë më prezentë në politikë. Përmes programit kemi realizuar më shumë se 600 vende pune me buxhet mjaftë të vogël ndërsa vitin e ardhshëm shpresoj të kemi një buxhet më të madh".

Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj ka vlerësuar punën e ministrit Demiri, ai potencoi se "Angazhimi i komuniteteve pakicë është shumë i sinqertë . Kam porositur ministrin e MZHR-së, z. Rasim Demiri, që të gjej punët të cilat nuk janë kryer asnjëherë më

parë. Unë kam punuar që ta krijojmë një besim dhe s’kam lejuar që marrëdhëniet tona të dëmtohen me komunitetet pakicë”, ka thënë Haradinaj.

Z. Fatos Qerimi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ka folur për rezultatet e kësaj ministrie për vitin 2018-të, sipas tij “MZHR-ja ka përcaktuar objektivat për 4 vitet e ardhme 2017- 21.

Foto 8: Kryeministri i Kosovës z. Ramush Haradinaj me Ministrin z. Rasim Demiri duke hyrë në Konferencë . **Foto 9**: Sekretari i MZHR-së, z. Fatos Qerimi duke e bërë hapjen e Konferencës.

Foto 10: Pasqyrojnë përmbylljen e Konferencës vjetore të MZHR-së së bashku më kryetaret e komunave, përfaqësuesit e bizneseve dhe OJQ-ve përfituese nga MZHR.